



Pranuar / Donesur / Submitted / Received / Received / Delivered	01.06	707	2	viti / year
Organ / Njesia / Organ / Jednotka / Org.-Unit	Nr Post / Post No	Shtypja / Printed / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity	
SKPM/SHCK	3206/2022		1/5	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 404/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për shqyrtimin e ankesave nga: Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.404 /2022 të datës 21.04.2022 të parashtruar nga ankuesi ne adresë banimi

kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.Nr.404/2022 e datës 21.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij, që ankuesit ti bëjë kompensimin e pagave nga data 06.08.2015 deri më datë 26.10.2020.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në sipas Aktgjykimit A.nr.1216/19 të datës 09.10.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimit AA.nr.852/2019 të datës 08.09.2020 të Gjykatës së

Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 31.12.2020 ka nxjerr Vendim me numër A.nr.363/2020 me të cilin ka obliguar Komunën e Prishtinës që ankuesin ta kthejnë në vendin e punës "Menaxher i Tatimit në Pronë" sipas Akt Emërimit të datës 15.02.2013, që nënkupton edhe kompensimin e pagave nga dita e ndërprerjeje së marrëdhënies së punës deri në zbatimin e këtij vendimi.

Komuna e Prishtinës më datë 26.10.2020 ka nxjerr vendim me të cilin ankuesin e ka kthyer në vendin e punës "Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit", duke përcaktuar që Drejtoria e Financave të bëjë kalkulimin financiar, ndërsa me Vendimin e datës 05.02.2021 ankuesi është sistemuar në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë", për faktin që pozita Menaxher i Tatimit në Pronë nuk është paraparë në organogramin e Komunës së Prishtinës.

Ankuesi më datë 21.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 2275/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të Kosovës, pretendon që Komuna e Prishtinës, duhet të sistemoj në pozitën Menaxher i Tatimit në Pronë; t'i bëjë kompensim e pagave nga data 06.08.2015 deri me datën 26.10.2020; kompensimin e punës jashtë orarit për periudhën 06.08.2015 deri me datën 26.10.2020 dhe kompensimin e pushimit vjetor të pashfrytëzuar për periudhën 06.08.2015 deri me datën 26.10.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës, Ndërsa me datë 17.05.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë të ankuesit si dhe shkresat lidhur me lëndën.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën e datës 21.04.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokollit 2275/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 18.06.2015, i Komisionit Disiplinor; Aktgjykimi A. Nr. 1216/19, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Aktgjykimi A Nr. 852/2019, i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Vendimi i datës 26.10.2020, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Vendimi i datës 31.12.2020 A. Nr. 363/2020, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 05.02.2021, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt Emërimi i datës 05.02.2021 01. Nr. 112-807; kërkesë e datës 04.03.2022, për zbatimin e Aktgjykimit; Akt Emërimi i datës 15.02.2013; Vendimi i datës 12.05.2015, i KPMSHCK; Vendimi i datës 26.10.2020, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; lista e pagave e datës 01.04.2014, deri me datë 30.04.2014; Lista e pagave e datës 13.05.2022; Akt Emërimi i datës 13.11.2020; Përgjigje në ankesë e datës 17.05.2022, me numër protokollit 2855/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon që të kthehet në vendin e punës Menaxher i Tatimit në Provë", ka konstatuar që me Vendimin me numër A.nr.363/2020 e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komuna e Prishtinës ka qenë e obliguar që ankuesin ta kthejë në vendin e punës "Menaxher i Tatimit në Pronë" sipas Akt Emërimit të datës 15.02.2013, mirëpo në bazë të Vendimit të datës 05.02.2021 ankuesi është sistemuar në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë", për faktin që pozita Menaxher i Tatimit në Pronë në bazë të Vendimit për Organizimin, Kompetencat, Përgjegjësitë dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës së Administratës Komunale me numër 01 Nr. 031-13761 të datës 19.01.2016 është emëruar "Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë", sepse në bazë të nenit 18 të këtij vendimi është paraparë Drejtoria e Financave, ndërsa me nenin 19 të këtij vendimi është paraparë organizimi i kësaj drejtorie në dy sektor: Sektori për buxhet dhe Financa dhe Sektori i Tatimit në Pronë, kështu që meqenëse Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë të shqyrtoj nxjerrjen e akteve për organizimin e brendshëm të institucioneve, konsideron që pozita Menaxher i Tatimit në Pronë dhe Udhëheqës i Sektorit të Tatimit në Pronë për kategorinë janë të barasvlershme, kështu që ka qenë e pamundur që ankuesi të kthehet në pozitën Menaxher i Tatimit në Pronë kur pozita është fuzionuar në një emërtim tjetër.

Sa i përket pretendimin ankimor të ankuesit, që Komuna e Prishtinës ka qenë e obliguar t'i bëjë kompensim e pagave nga data 06.08.2015 deri me datën 26.10.2020, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se me vetë faktin që me Aktgjykimin A.nr.1216/19 të datës 09.10.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.852/2019 të datës 08.09.2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative, është konstatuar që ndërprerja e marrëdhënies së punës së ankuesit ka qenë e kundërligjshme, ndërsa me Vendimin me numër A.nr.363/2020 e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Komuna e Prishtinës është kthyer në vendin e punës, atëherë Komuna e Prishtinës ka qenë e obliguar që ankuesit t'i bëjë kompensimin e pagave nga dita e ndërprerjeje së marrëdhënies së punës deri në kthimin në vendin e punës, kështu që pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se duhet t'i kompensimi i punës jashtë orarit për periudhën 06.08.2015 deri me datën 26.10.2020, konstaton se me nenin 15 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: "1.Në institucionet e administratës publike, ku ekziston nevoja për punë me ndërrime sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin e Shërbimit Civil, nëpunësit civilë, të cilët punojnë në ndërrime jashtë orarit të rregullt të punës, kanë të drejtë të marrin shtesën për punë me ndërrime", ndërsa me nenin 11 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores

Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, është përcaktuar se: *1. Në pajtim me Nenin 21 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësit kanë të drejtë të kompensohen për punën jashtë orarit, me pagesë ose me kohë të lirë. 2. Nëpunësit civilë kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë për punën jashtë orarit, nëse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën jashtë orarit*", prandaj Kolegji, konstaton së meqenëse ankuesit i'u është ndërprere marrëdhënia e punës, atëherë nuk ka dëshmi që të ketë punuar punë jashtë orarit të punës, andaj edhe nuk mund të kompensohet për një gjë për të cilën nuk ka dëshmi që ka punuar, andaj pretendimi i ankuesit është i pabazuar, sepse nuk janë përmbushur kushtet ligjore për këtë kompensim.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit për kompensimin e ditëve të pushimit vjetor të pashfrytëzuar për periudhën 06.08.2015 deri me datën 26.10.2020, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që neni 39 paragrafi 7 i Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ka përcaktuar që: *"Pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar"*, mbi bazë të kësaj neni 5 paragrafi 8 të Rregullores Nr. 06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: *"Në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Shërbimi Civil, nëpunësi civil kompensohet me pagesë të kalkuluar për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor. Në rastin e kundërt, nëse ditët e pushimit vjetor janë shfrytëzuar para kohës së fitimit të drejtës për pushim, atëherë nga paga e fundit bëhen ndalesat e kalkuluara për ditët e pa fituara"*, kështu që ndërprerja e marrëdhënies së punës së ankuesit është si rezultat i masës disiplinore, dhe e njëjta nuk është si rezultat i përcaktuar me Kreun IX të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se nëse i referohemi Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 18 paragrafi 4, përcaktohet se: *"Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës"*, ndërsa sipas Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, konkretisht nenit 32 paragrafi 5, përcaktohet se: *"Ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor nuk mund të kompensohen me para, përjashtimisht kjo mund të bëhet kur marrëdhënia e punës i skadon të punësuarit"*, Andaj meqenëse ankuesi nuk i skaduar marrëdhënia e punës, atëherë nuk mund të bëhet kompensimi në rastet e tilla, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komuna e Prishtinës, konkretisht Kryetari i Komunës është i obliguar të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagave për ankuesin nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në kthim në vendin e tij të punës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr. 404/2022

Rushit KAJTAZI



Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

